



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

A. nr.572/ 20

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, neni 4 Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, si dhe nenin 17 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE “Menti shpk”, Banjë-Istog, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i zhveshtoreve në stadiumin e futbollit “Demush Mavraj”, me numër të prokurimit AP 633/20/1797/521 dhe numër të brendeshme: 633/20/022/521”, të iniciuar nga AK Komuna e Istogut, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 19 GUSHT 2020 mori këtë :

VENDIM

- I. **Hedhet si e pa lejuar** ankesa e OE; “Menti shpk” Banjë-Istog, me nr. të protokollit. 572/20, e datës: 17 GUSHT 2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i zhveshtoreve në stadiumin e futbollit “Demush Mavraj”, me numër të prokurimit AP 633/20/1797/521 dhe numër të brendeshme: 633/20/022/521”, të iniciuar nga AK Komuna e Istogut.

- II. **Mbetet i Pezulluar**, aktiviteti i prokurimit: “Ndërtimi i zhveshtoreve në stadiumin e futbollit “Demush Mavraj”, me numër te prokurimit AP 633/20/1797/521 dhe numër te brendeshme:633/20/022/521”, te iniciuar nga AK Komuna e Istogut, deri në nxerrjen e një vendimi nga PSH, pasi që për këtë aktivitet ka ankes e cila është në shqyrtim të rregullt nga OSHP-ë.
- III. Ankesa e operatorit ekonomik, “Menti shpk” Banjë-Istog, nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është proceduar sipas nenit 108/A dhe 109 të LPP-së si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoritetit kontraktues, parashtrimit të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave , operatorit ekonomik ankues sipas nenit 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet tarifa e ankesës.
- IV. **Obligohet**, OE ankues që konform nenit 31 pika 6 te Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Më datën 17 GUSHT 2020, në Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e OE “Menti shpk”, Banjë-Istog, e cila ankesë protokollohet me nr. të protokolli. 572/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i zhveshtoreve në stadiumin e futbollit “Demush Mavraj”, me numër te prokurimit AP 633/20/1797/521 dhe numër te brendeshme:633/20/022/521”, te iniciuar nga AK Komuna e Istogut.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE “Menti shpk” Banjë-Istog, me nr. të protokolli. 572/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i zhveshtoreve në stadiumin e futbollit “Demush Mavraj”, me numër te prokurimit AP

633/20/1797/521 dhe numër te brendeshme:633/20/022/521”, te iniciuar nga AK Komuna e Istogut dhe bazuar në verifikimin e shkresave te lendes si dhe ne platformën e-prokurimi kjo ankesë rezulton te jete e pa lejuar.

Nga se Autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Istogut për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i zhyeshitoreve në stadiumin e futbollit “Demush Mavraj”, me numër te prokurimit AP 633/20/1797/521 dhe numër te brendeshme:633/20/022/521”. Me Njoftimin për anulim të aktiviteti te prokurimit dhe me Letrën Standarde e ka njoftuar OE ankues me dt.29.07.2020, ora 15:00.

Kundër Njoftimit te lartcekur Operatori ekonomik (OE) ankues ka parashtruar kërkesës për Rishqyrtim të vendimit të AK-së me dt. 03.08.2020 në ora 20:01

AK me dt.06.08.2020, ora 11:13, e ka njoftuar OE ankues me vendim për refuzim si te pa bazuar te kërkesës për Rishqyrtim .

Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se duke pas parasysh faktin se AK me Njoftimin për anulim të aktiviteti te prokurimit dhe me Letrën Standarde e ka njoftuar OE ankues me dt.29.07.2020, ora 15:00 , afati ligjor sipas LPP-së , për parashtrim të kërkesës për Rishqyrtim për OE ne fjalë ka filluar te rrjedh nga data 30.07.2020,nga ora 08:00 deri në ora 16:00, dhe ka përfunduar me datën 03.08.2020 ora 16:00(duke pas përsysh faktin se dita e njoftimit llogaritet dita 0).

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se OE “Menti shpk” Banjë-Istog, ka humbur afatin ligjor për parashtrim te kërkesës për rishqyrtim ne AK andaj ankesa e datës 17.08.2020 me numër te protokollit 572/20, nuk mund te shqyrtohet nga OSHP dhe e njëjta hedhet si e pa lejuar .

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 5 i LPP-së specifikon :

Kalkulimi i afateve kohore

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë

pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 9 paragrafi 1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon: Ankesa pranë OSHP-së, duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE: "MENTI" shpk e dt. 17.08.2020, me numër të Protokollit 572/2020, hodhët si e pa lejuar sepse ankuesi ka parashtruar ankese në OSHP në kundërshtim me nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Istogut

1x1 OE "OE "MENTI" shpk

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së

Kryesuesi Sekretariatit të OSHP-së

Ardian BEHRA